



Financuar nga
Bashkimi Evropian

EURALIUS
Consolidation of the
Justice System in Albania

Heqje dorë nga përgjegjësia:

Jeni të lutur të vini re se ky dokument përbën një konsolidim jozyrtar të destinuar vetëm për qëllime informimi. Teksti nuk jep asnjë të drejtë dhe nuk imponon asnjë detyrim të ndryshëm nga çfarë parashikohet në legjislacionin e miratuar dhe të botuar në Fletoren Zyrtare. EURALIUS nuk garanton saktësinë dhe nuk mban përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit të mëposhtëm.

VENDIM

Nr.311, datë 5.5.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E AFATIT, TË PËRMBAJTJES DHE TË MËNYRËS SË NJOFTIMIT PUBLIK PËR
PROCEDURAT E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN SHTETËROR, NË ZONAT ME
PËRPARËSI TURIZMIN**

(Ndryshuar me Vendimin Nr. 45, datë 21.1.2015)¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.10186, datë 5.11.2009 "Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin", me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njoftimi për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin, në zonat me përparësi turizmin, publikohet:

- a) në faqen zyrtare të ALUIZNI-t dhe të Agjencisë Kombëtare të Turizmit;
- b) në dy gazeta kombëtare, për 5 ditë të njëpasnjëshme kalendarike;
- c) pranë njësive përkatëse të qeverisjes vendore.

2. Njoftimi publik përmban:

- a) afatin brenda të cilit subjekti i interesuar dhe personi i stimuluar duhet të paraqesin dokumentet pranë ALUIZNI-t, sipas ligjit nr.10186, datë 5.11.2009 "Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin";

¹ Për zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit.

- b) llojin e dokumenteve që duhet të paraqesë subjekti i interesuar/personi i stimuluar;
- c) masën e tarifës që duhet paguar.

3. Efektet financiare të njoftimit publik përballohen nga buxheti i ALUIZNI-t. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha